

Hidro Mentori Sh.p.k
Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

Përmbajtja

Raport i Audituesit të Pavarur	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	6
Pasqyra e Performancës.....	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	8
Pasqyra e Flukseve të Parasë	9
Shënimet Shpjeguese.....	10-19

Margarita Kalemasi

Rruga Asim Vokshi,

Nd. 14, H. 6, Ap. 27

Kodi Postar 1016

Tiranë, Shqipëri

+355 4 242 0666

m.kalemasi@joncon.al

Raport i Audituesit të Pavarur

Për pronarin e Hidro Mentori Sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Hidro Mentori Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, dhe pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e rrjedhjes së mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Palëve të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, si edhe sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazaë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të përshtatshme me

- rrethanat, por jo për të shprehur një opinionin mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brëndshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyestuehmërinë, e çmuarjeve kontabël si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditues ligjor
Margarita Kalemasi

I.E.K.A. Margarita KALEMASI
Rruga Asim Vokshi
Nd. 14, Hll. 6, Ap. 27
Kodi Postar 1016
Licence Nr. 156

Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më 06 mars 2018

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Pozicionit Financiar

		31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET	Shënimi		
Aktivët Afatshkurtra			
<i>Para në arkë dhe bankë</i>	4	77,776,370	64,588,104
<i>Llogari të arkëtueshme, klientë</i>	5	44,647,398	63,731,667
<i>Llogari të arkëtueshme të tjera</i>	6	2,403,756	-
<i>Inventarë</i>	7	8,510,715	8,054,570
<i>Aktive të tjera</i>	8	94,672,262	76,044,520
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		228,010,501	212,418,861
Aktivët Afatgjatë			
<i>Aktive Afatgjatë Materiale</i>	9	1,079,872	1,360,167
Totali i Aktiveve Afatgjatë		1,079,872	1,360,167
TOTALI I AKTIVEVE		229,090,373	213,779,028
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet Afatshkurtra			
<i>Hua bankare afatshkurtër</i>		351,838	-
<i>Të pagueshme ndaj furnitorëve</i>	10	8,366,874	752,039
<i>Detyrime të tjera afatshkurtra</i>	11	232,831	9,346,691
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		8,951,543	10,098,730
Detyrimet Afatgjatë			
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		-	-
Totali i Detyrimeve Afatgjatë		-	-
TOTALI I DETYRIMEVE		8,951,543	10,098,730
Kapitali			
<i>Kapitali i paguar</i>	12	16,500,000	16,500,000
<i>Rezerva</i>	13	187,180,298	129,002,740
<i>Fitim / (Humbja e Vitit)</i>		16,458,533	58,177,558
TOTALI I KAPITALIT		220,138,831	203,680,298
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		229,090,373	213,779,028

Pasqyrat financiare bashkë me shënimet shpjeguese nga faqja 10 deri 19 janë dhe aprovuar nga administratori më 31 Janar 2018.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Diana VESHAJ

Administratori

Mentor KADRIAJ



Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Performancës

		31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhurat	Shënimi		
<i>Të ardhurat</i>	14	177,079,869	427,332,287
<i>Kosto e mallrave të shitur</i>	15	100,766,593	307,702,439
Fitimi bruto		76,313,276	119,629,848
<i>Shpenzime administrative dhe operative</i>	16	20,602,556	40,547,680
<i>Provizion borxhi i keq</i>	5	24,210,054	
<i>Shpenzime financiare, neto</i>	17	7,856,747	9,566,945
<i>Shpenzime të tjera, neto</i>	18	7,290	910,382
Totali i shpenzimeve		52,676,647	51,025,007
Fitimi para tatimit		23,636,629	68,604,841
<i>Shpenzimi për tatim fitimin</i>	19	7,178,096	10,427,283
FITIMI NETO I VITIT		16,458,533	58,177,558

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni financiar më 31.12.2015	16,500,000	472,211	128,530,529	145,502,740
Fitimi / Humbja e vitit			58,177,558	58,177,558
Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital				-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar				-
Pozicioni financiar më 31.12.2016	16,500,000	472,211	186,708,087	203,680,298
Fitimi / Humbja e vitit			16,458,533	16,458,533
Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital				-
Dividendë të paguar				-
Pozicioni financiar më 31.12.2017	16,500,000	472,211	203,166,619	220,138,830

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Flukseve të Parasë

		31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETI OPERATIV	Shënim		
Fitimi neto para tatimit		23,636,629	68,604,841
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësim dhe amortizim	9	280,296	312,930
Ndryshim në inventarë	7	(456,145)	(3,358,155)
Ndryshim në llogari të arkëtueshme	5,6	(1,947,229)	(12,969,023)
Ndryshim në llogari të pagueshme	10,11	(1,499,025)	(24,059,930)
Tatim fitimi i paguar		(7,178,096)	(10,427,283)
Fluksi i parasë neto gjeneruar nga aktivitetet operative		12,836,430	18,103,380
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE INVESTUESE			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		-	(971,877)
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese		-	(971,877)
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE FINANCUESE			
Hua të marra		351,838	-
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet financuese		351,838	-
Rritje neto në para dhe ekuivalentët		13,188,266	17,131,503
Para dhe ekuivalentët në fillim të vitit	4	64,588,104	47,456,601
Para dhe ekuivalentët në fund të vitit	4	77,776,370	64,588,104

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

HIDRO MENTORI Sh.p.k (“Shoqëria”) u krijua si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 29 Prill 2011 dhe u regjistrua me emrin tregtar NT MENTORI Sh.p.k, të cilin e ndryshoi më 16 Janar 2018. Kapitali i shoqërisë përbëhet prej 100 kuotash me vlerë 165.000 lekë secila.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është tregëtimi i artikujve të ndryshëm insustrialë, pajisjeve dhe materialeve të ndryshme për ujësjellës kanalizime.

Adresa e shoqërisë është Rruga Muhamet Gjollësja, Godina 4-katëshe pranë Karburant “Kastrati”, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 Dhjetor 2017, shoqëria kishte 6 punonjës (31 Dhjetor 2016: 6 të punësuar).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të ndryshuar, dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri dhe të përmirësuara me efekt nga 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
1 EUR	132.95	135.23
1 USD	111.10	128.17

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivët dhe detyrimet financiarë njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Mjetet monetare dhe ekuivalentët t tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjëndje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

3.3 Inventari

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjëndjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme i referohet çmimit të shitjes që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit, minus të gjitha kostot e vlerësuara për ndërlikimin e biznesit.

3.4 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe do të kërkojë flukse dalëse monetare të ardhshme për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset monetartë ardhshme të pritshme me një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen kur është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me to do të në favor të Shoqërisë dhe kur vlera e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur rreziqet dhe përfitimet thelbësore të lidhura me pronësinë transferohen nga shitësi te blerësi. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në fitime ose humbje.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesat nga huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka. Ky tatim llogaritet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatim fitimi aktual përfshin gjithashtu çdo tatim që rezulton nga dividendët. Tatim fitimi aktual i pagueshëm ose i arkëtueshëm kompensohen vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjen tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferenca të përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktiviteti tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyre vetëm në qoftë se kriteret e caktuara përmbushen.

4. PARA NË ARKË DHE BANKË

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Para në arkë	356,195	609,168
Para në bankë	63,414,858	61,258,136
Totali i parasë dhe ekuivalentëve të saj	63,771,053	61,867,304
Garanci bankare	14,005,317	2,720,800
Totali i parasë në arkë dhe bankë	77,776,370	64,588,104

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga llogaritë në lekë dhe në euro që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në Shqipëri si dhe gjëndja e arkës në datën e raportimit.

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme nga klientë	68,857,452	63,731,667
Provizion për borxhin e keq	(24,210,054)	-
Llogari të arkëtueshme neto	44,647,398	63,731,667

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshme nga klientët për shitjen e mallrave dhe produkteve të tjera nga aktiviteti kryesor i Shoqërisë. Lëvizja për borxhin e keq deri më 31 dhjetor 2017 paraqitet si në vijim:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Më 1 janar,	-	-
Provizion për vitin për borxhin e keq	24,210,054	-
Më 31 dhjetor	24,210,054	-

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

6. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i arkëtueshëm	1,591,132	-
TVSH e arkëtueshme	812,624	-
Totali	2,403,756	-

7. INVENTARË

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mallra dhe produkte për shitje	8,510,715	8,054,570
Totali	8,510,715	8,054,570

8. AKTIVE TË TJERA

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua palëve të lidhura (HM Kosovë)	94,672,262	96,580,878
Totali	94,672,262	96,580,878

Të arkëtueshme dhe hua për palë të lidhura përfaqësojnë ndihma afatshkurtra me të drejtë kthimi ndaj Hidro Mentori Kosovë.

9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivete materiale	Mjete transporti	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
<i>Kosto</i>				
Më 1 janar 2016		935,637	426,203	1,361,840
Shtesa	950,000	21,877	-	971,877
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	950,000	957,514	426,203	2,333,717
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	950,000	957,514	426,203	2,333,717
<i>Zhvlerësim i akumuluar</i>				
Më 1 janar 2016		(454,717)	(205,903)	(660,620)
Shpenzime për vitin	(158,333)	(99,522)	(55,075)	(312,930)
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	(158,333)	(554,239)	(260,978)	(973,550)
Shpenzime për vitin	(158,333)	(80,655)	(41,307)	(280,295)
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	(316,666)	(634,894)	(302,285)	(1,253,845)
<i>Vlera e mbartur</i>				
Më 31 dhjetor 2016	791,667	403,275	165,225	1,360,167
Më 31 dhjetor 2017	633,334	322,620	123,918	1,079,872

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

10. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë për mallra	8,210,274	749,039
Furnitorë për shërbime dhe të tjera	156,600	3,000
Totali	8,366,874	752,039

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve përbëhen kryesisht nga të pagueshme për blerjen e mallrave dhe të produkteve për aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

11. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

Detyrimet e tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kontributet shoqërore e shëndetësore	107,931	95,248
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	100,580	109,654
Tatimi i mbajtur në burim	9,975	8,160
Tatim fitimi	-	6,317,831
TVSH e pagueshme	-	2,815,798
Paga e shpërblime	14,345	-
Totali	232,831	9,346,691

12. KAPITALI I PAGUAR

Më 31 dhjetor 2017 aksionari i vetëm i Shoqërisë është Z. Mentor Kadrijaj. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është 16,500,000 LEK me 100 aksione me vlerë nominale prej 165,000 secila.

13. REZERVA

Rezerva ligjore të krijuara nga Shoqëria më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 kanë një vlerë prej 472,211 LEK. Rezervat e tjera të krijuara nga Shoqëria deri më 31 dhjetor 2017 kanë një vlerë prej 203,166,620 LEK (2016: 186,708,087 LEK).

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

14. TË ARDHURAT

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shitje mallrash	172,560,343	404,615,506
Shërbimesh	2,320,999	-
Aktivitetet e tjera	2,198,527	22,716,781
Totali	177,079,869	427,332,287

Të ardhurat nga shërbimet janë kryesisht të ardhura të përfituara në bazë të kontratës së lidhur me P.I.U për shërbimin e trajnimit të punonjësve.

Të ardhurat nga aktivitetet e tjera përfaqësojnë të ardhurat nga transportet për të tretët.

15. KOSTO E MALLRAVE TË SHITUR

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjëndje në fillim	8,054,570	4,696,415
Blerje gjatë vitit	101,222,738	311,060,595
Gjëndje në fund	8,510,715	8,054,570
Totali KMSH	100,766,593	307,702,440

16. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE OPERATIVE

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime personeli	6,044,729	5,525,382
Shpenzime për udhëtime e dieta	4,115,774	8,696,909
Shpenzime transporti dhe të ngashme	4,111,478	20,672,000
Qira	684,100	869,768
Shpenzime bankare	677,264	910,000
Energji, karburant etj.	518,858	311,000
Shpenzime telekomunikacioni dhe postare	447,472	486,043
Shpenzime profesionale	398,434	469,967
Mirëmbajtje dhe riparime	308,629	10,167
Amortizimi	280,295	312,930
Shpenzime për pjesëmarrje dhe anëtarime	227,420	526,862
Taksa dhe tarifa të ndryshme	135,916	101,000
Komisione bankare	677,264	953,655
Shpenzime të tjera administrative	1,974,924	701,998
Totali	20,602,556	40,547,680

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

17. SHPENZIME FINANCIARE, NETO

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Humbje neto nga kurset e këmbimit	7,851,580	9,567,020
Shpenzime interesi	10,315	5
Të ardhura nga interesi	(5,148)	(80)
Totali	7,856,747	9,566,945

18. SHPENZIME TË TJERA, NETO

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjoba dhe penalitete	7,290	910,382
Totali	7,290	910,382

19. TATIM FITIMI

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	23,636,629	68,604,841
<i>Diferenca të përkohshme për të cilat nuk është njohur tatim i shtyrë:</i>		
Provigjon për borxhin e keq	24,210,054	-
<i>Rregullime për shpenzime të panjohura:</i>		
Gjoba dhe penalitete	7,290	910,382
Fitimi i tatueshëm i vitit	47,853,973	69,515,223
Shpenzimi për tatim fitimin me 15%	7,178,096	10,427,283

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

20. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

20.1 Veprime në lidhje me aktivitetin

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka pasur veprime me palë të lidhura për aktivitetin e saj si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Blerje mallrash dhe/ose shërbimesh</i>		
Shoqëri në pronësi të aksionarit të vetëm	-	20,672,000
Shoqëri të tjera të lidhura	-	-
Totali	-	20,672,000

Blerjet janë bërë me çmimet e tregut që reflektojnë cilësinë e produkteve dhe/ose shërbimeve si dhe marrëdhënien e biznesit mes palëve.

Tepçicat e mbetura më 31 dhjetor 2017 me palët e lidhura të shoqërisë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Llogari të arkëtueshme</i>		
Shoqëri në pronësi të aksionarit të vetëm	81,177,262	66,242,166
Shoqëri të tjera të lidhura	13,494,999	-
Totali	94,672,261	66,242,166

Vlerat e mbetura në fund të vitit do të shlyhen përkatësisht sipas natyrës.

21. NGJARJE PAS PERIU DHËS RAPORTUESE

Pas datës së pasqyrave financiare nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë.